



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATURA E SHTETIT
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM TË SHTETIT

Nr. 1108 prot.

Tiranë, më 26.03.2019

URDHËR

Nr. 61, datë 26.03.2019

**“PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT “PËR PROVIMIN FILLESTAR TË PROCESIT TË
PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE PËR POZICIONIN E AVOKATIT TË SHTETIT
GJATË REGJIMIT LIGJOR KALIMTAR”**

Në mbështetje të shkronjës “a”, të nenit 6, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 6, të Kreut II, të Rregullores “Për procedurat e organizimit dhe zhvillimit të procesit të rekrutimit, pranimit, periudhës së provës dhe emërimit të kandidatëve për pozicionin e avokatit të shtetit gjatë regjimit ligjor kalimtar”, miratuar me Urdhrin Nr.60, datë 26.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit,

URDHËROJ:

1. Miratimin e programit “Për provimin fillestar të procesit të përzgjedhjes së kandidatëve për pozicionin e avokatit të shtetit gjatë regjimit ligjor kalimtar”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohet Zyra e Protokollit pranë Avokaturës së Shtetit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

Artur Metani





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATURA E SHETIT**

**PROGRAM
“PËR
PROVIMIN FILLESTAR TË PROCESIT TË PËRZGJEDHJES SË
KANDIDATËVE PËR POZICIONIN E AVOKATIT TË SHETIT GJATË
REGJIMIT LIGJOR KALIMTAR”**

Miratuar me Urdhrin Nr.61, datë 26.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit

E Drejta Kushtetuese

1. Kuptimi i pavarësisë së pushtetit gjyqësor;
2. Marrëdhëniet e Presidentit të Republikës me pushtetin gjyqësor;
3. Këshilli i Lartë Gjyqësor, përbërja dhe roli i tij;
4. Kriteret dhe kushtet e nevojshme për të qenë Gjyqtar në Shqipëri;
5. Procesi i përzgjedhjes, i emërimit dhe i shkarkimit të gjyqtarëve në Shqipëri;
6. Masat disiplinore dhe transferimi i gjyqtarëve;
7. Statusi i gjyqtarit;
8. Papajtueshmëritë me detyrën e gjyqtarit;
9. Struktura e sistemit gjyqësor në Shqipëri;
10. Arsytimi i vendimeve gjyqësore dhe rëndësia e publikimit të tyre;
11. Juridiksioni i Gjykatës së Lartë;
12. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe unifikimi i praktikës gjyqësore;
13. Prokuroria dhe funksionet kryesore të saj;
14. Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Procesi i përzgjedhjes, emërimit dhe shkarkimit të prokurorëve në Shqipëri;
15. Prokuroria e Posaçme;
16. E Drejta për një proces të rregullt ligjor;
17. Liritë negative dhe liritë pozitive;
18. Të drejtat themelore të njeriut dhe objektivat sociale;
19. Liria personale (*Habeas Corpus*);
20. E drejta për të jetuar;
21. E drejta për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, ç`njerëzor ose poshtëruës;
22. E drejta e mbrojtjes me avokat për të pandehurin;
23. E drejta për t`u ankuar kundër një vendimi gjyqësor;
24. Parimi i mosfuqisë prapavepruese të ligjit në Kushtetutë, roli i tij në sigurimin e të drejtave personale;
25. Parimi i prezumimit të pafajësisë në Kushtetutë. Roli i tij për garantimin e lirisë së personit;
26. Parimi i gjësë së gjykuar në Kushtetutë dhe zbatimi i tij në çështjet civile e penale. Roli i tij për garantimin e të drejtave;
27. Garancitë procedurale për të pandehurin në procesin penal;
28. E Drejta për të gëzuar një jetë private të qetë;
29. E Drejta për t`u organizuar kolektivisht;
30. Aktet normative, kriteret e klasifikimit të tyre në Kushtetutën e Shqipërisë;
31. Sistemi monist dhe sistemi dualist i së drejtës. Rasti i Shqipërisë;
32. Kuptimi i Shtetit ligjor dhe shtetit të së drejtës;
33. Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit në Kushtetutë;
34. Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi për shkak të gjinisë;
35. Kuptimi i rezervës ligjore në Kushtetutë dhe garancitë për mbrojtjen e të drejtave nga cenimet arbitrare (*proporcionaliteti dhe garancia e thelbit*);
36. Konventa Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, statusi i saj sipas Kushtetutës së Shqipërisë;
37. Procedurat parlamentare për miratimin e ligjeve;
38. Ligjet për rishikimin e Kushtetutës. Dallimet nga ligjet e zakonshme;
39. Drejtësia Kushtetuese; sistemet e drejtësisë kushtetuese; llojet e kontrollit kushtetues; Drejtësisë Kushtetuese sipas Kushtetutës së Shqipërisë;
40. Gjykata Kushtetuese si garantuese e Shtetit të së drejtës. Funksioni, kompetencat;
41. Procesi i emërimit dhe shkarkimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese në Shqipëri;
42. Procesi kushtetues: Vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese;
43. Gjykimi kushtetues; vendimi i Gjykatës Kushtetuese;
44. Ankimi individual kushtetues;

45. Raporti midis gjykatave të zakonshme dhe Gjykatës Kushtetuese në Shqipëri.

Legjislacioni:

- Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.8137, datë 31.7.1996 “Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut”;
- Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;
- Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;
- Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”;
- Ligji nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”;
- Rregullore e Kuvendit të Shqipërisë miratuar me vendimin nr. 166, datë 16.12.2004, e ndryshuar;
- Vendimi nr. 584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”.

E Drejta Administrative

1. Parimet e përgjithshme të administratës publike sipas Kodit të Procedurave Administrative të vitit 2015. Parimi i ligjshmërisë, i barazisë dhe i proporcionalitetit, i drejtësisë dhe i paanësisë, i përgjegjshmërisë, i transparencës dhe të tjerë;
2. Organet e pushtetit qendror dhe të qeverisjes vendore. Këshilli i Ministrave, kryeministri, ministri, organet e varura dhe degët territoriale, prefekti, Këshilli i bashkisë, kryetari i bashkisë, këshilli i qarkut, kryesia dhe kryetari; zgjedhja dhe ushtrimi i veprimtarisë së tyre;
3. Organizimi dhe funksionimi i organeve të administratës publike. Funksionimi i administratës shtetërore, Etika në administratën publike; Korrupsioni; Konflikti i interesave, strukturat përgjegjëse;
4. Organe të pavarura, ILDKPI, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen kundër Diskriminimit, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtës për informim;
5. Kundravajtjet administrative dhe elementet përbërës të saj. Nisja e procedimit administrativ; procedura për dhënieve administrative. Organet e gjyqimit të kundravajtjes;
6. Koncepti për aktin administrativ. Forma, përmbajtja, qëllimi dhe arsyetimi i aktit administrativ. Veçoritë e aktit administrativ. Dallimi midis aktit administrativ dhe vendimit gjyqësor. Dallimi ndërmjet aktit dhe kontratës administrative e veprimit tjetër administrativ;
7. Mënyrat e klasifikimit të aktit administrativ. Klasifikimi i aktit sipas nismës, formës, efekteve, karakterit të përmbajtjes dhe emërtimeve;
8. Efektet juridike të aktit administrativ. Nxjerrja, shpallja dhe hyrja në fuqi e aktit, prapaveprueshmëria dhe ekzekutimi i aktit;
9. Kuptimi për ligjshmërinë e aktit administrativ. Kompetenca, delegimi, zëvendësimi, spostimi, juridiksioni; Procedura që ndiqet për nxjerrjen e aktit juridik administrativ;

10. Kuptimi për paligjshmërinë. Kundërshtimi i paligjshmërisë dhe pavlefshmërisë së aktit administrativ. Dallimi i akteve të paligjshme nga aktet administrative absolutisht të pavlefshme. Dallimi ndërmjet anulimit dhe shfuqizimit;
11. Pushimi i fuqisë së aktit. Pushimi faktik; pushimi juridik (shfuqizimi e anulimi nga vetë organi kompetent, nga organi më i lartë dhe nga gjykata);
12. Mjetet ligjore administrative. Format dhe efektet e ankimit administrativ; Shqyrtimi i ankimit administrativ; Llojet, afati dhe fazat e shqyrtimit të ankimit administrativ; Paapelueshmëria e aktit administrativ; Ankimi administrativ dhe padia gjyqësore. Kundërshtimi administrativ dhe Rishikimi.
13. Procedura administrative. Palët në një procedurë administrative; Fillimi i procedurës administrative; Përfundimi i procedurës administrative;
14. Ekzekutimi i aktit. Kuptimi për ekzekutimin e aktit; Mënyrat e ekzekutimit të aktit administrativ; Procedura për ekzekutimin e aktit administrativ;
15. Rishikimi gjyqësor dhe rishikimi kushtetues i aktit administrativ. Koncepti i rishikimit gjyqësor; bazat, parimet, qëllimi dhe shkaqet e rishikimit gjyqësor;
16. Gjykatat administrative. Sistemi shqiptar i drejtësisë administrative. Parimet mbi të cilat zhvillohet procesi i gjykimit administrativ. Procesi inkuizitor, Procesi mbi bazë dokumentesh, Procesi kontradiktor, Procesi i shpejtë;
17. Gjykimi administrativ në shkallë të parë, në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në Gjykatën e Lartë;
18. Aktet diskreciale, kontratat administrative dhe aktet reale. Koncepti për diskrecionin; kontratat administrative; aktet reale ose veprimi tjetër administrativ.

Legjislacioni:

- Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
- Ligji nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”;
- Ligji nr. 90, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”;
- Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligji nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
- Ligji nr. 8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”;
- Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Ligji nr. 8510, datë 15.7.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”;
- Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9367, datë 07.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- Ligji nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”;
- Ligji nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr.8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”;
- Ligji nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”;

- Ligji nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.
- Ligji nr. 8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”;
- Ligji nr. 8653, datë 31.7.2000, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 8654, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”;
- Vendimi nr. 714, datë 22.10.2004 i Këshillit të Ministrave “Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”;
- Vendimi nr. 867, datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”.

E Drejta Civile

1. Kuptimi i marrëdhënies juridike civile, veçoritë dhe elementet e saj.
2. Subjektet e së drejtës civile sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Veçoritë e disa personave juridikë shtetërorë, institucionet, ndërmarrjet. Banka e shtetit, Shteti si subjekt i posaçëm.
3. Zotësia juridike, përmbajtja, fillimi dhe mbarimi i saj. Zotësia për të vepruar. Personat me zotësi të plotë për të vepruar, me zotësi të kufizuar dhe të pazotë. Mbarimi, heqja dhe kufizimi i zotësisë për të vepruar. Shpallja i zhdukur dhe shpallja i vdekur.
4. Banimi dhe rëndësia e tij në të drejtën civile. Vendqëndrimi dhe kuptimi i tij.
5. Kuptimi i personit juridik. Tiparet e tij.
6. Mënyrat e krijimit të personit juridik. Zotësia juridike dhe ajo për të vepruar e personit juridik.
7. Mbarimi i personit juridik.
8. Llojet e personave juridikë.
9. Gjendja Civile, aktet e Gjendjes Civile dhe dallimi i tyre nga faktet që regjistrohen në regjistrin themeltar. Dallimi midis regjistrave të Gjendjes Civile dhe atyre të akteve të Gjendjes Civile.
10. Klasifikimi i sendeve dhe rëndësia e këtij klasifikimi.
11. Kuptimi i parasë dhe i letrave me vlerë.
12. Kuptimi, elementet dhe klasifikimi i veprimeve juridike.
13. Kuptimi i pavlefshmërisë së veprimeve juridike. Llojet e pavlefshmërisë dhe rëndësia e këtij dallimi.
14. Pasojat e pavlefshmërisë juridike. Pasojat te personat e tretë.
15. Kushti dhe afati në veprimet juridike. Kuptimi dhe dallimi.
16. Kuptimi dhe përmbajtja e përfaqësimit, kufijtë dhe pasojat e tij. Zëvendësimi në përfaqësim dhe pasojat e tij.
17. Prokura, kuptimi, forma, llojet e saj.
18. Përfaqësimi pa tagra. Kuptimi dhe pasojat e tij.
19. Kuptimi i parashkrimit, fusha e zbatimit të tij dhe rëndësia e tij.
20. Afatet e parashkrimit, kuptimi dhe mënyra e llogaritjes së tyre.
21. Pezullimi i parashkrimit, shkaqet dhe pasojat e tij. Kushtet që duhet të ekzistojnë që të kemi pezullim të afatit të parashkrimit.
22. Ndërprerja e parashkrimit, kuptimi, shkaqet dhe pasojat e saj.
23. Pasojat që sjell plotësimi i afateve të parashkrimit.
24. Parashkrimi i vënies në ekzekutim të vendimeve gjyqësore dhe të titujve ekzekutivë. Afatet dhe rregullat që duhen ndjekur për ekzekutimin e tyre kur pushohet ose pezullohet ekzekutimi.
25. Pronësia dhe llojet e saj.
26. E drejta subjektive e pronësisë, kuptimi, përmbajtja dhe objekti i saj.
27. Elementet e së drejtës subjektive të pronësisë, kuptimi, pavarësia dhe kufizimet e tyre.

28. Bashkëpronësia në pjesë. Kuptimi dhe përmbajtja e saj. Administrimi, disponimi dhe pjesëtimi i saj.
29. Kuptimi i bashkëpronësisë së detyrueshme.
30. Kuptimi i fitimit të pronësisë dhe mënyrat e fitimit të saj. Rëndësia e dallimit të mënyrave të fitimit në të parme dhe të prejdardhura.
31. Mënyrat e posaçme të fitimit të pronësisë.
32. Mënyrat e përgjithshme të fitimit të pronësisë dhe rëndësia e tyre. (Kontrata, fitimi me mirëbesim, fitimi me parashkrim, me trashëgimi, me anë të të ardhurave, në bazë të ligjit ose të një vendimi të organit shtetëror.)
33. Legjislacioni shqiptar për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe rastet praktike të lidhura me të.
34. Humbja e pronësisë, kuptimi dhe shkaqet.
35. Mbrojtja e pronësisë, kuptimi dhe mjetet juridike të saj. Të gjitha llojet e padive, (pacia mohuese, pacia e rivendikimit, pacia e kallëzimit të punimit të ri etj.) kushtet e ngritjes së tyre dhe pasojat.
36. Përgjegjësia e nëndorësit të paditur për të ardhurat, për sendin dhe të drejtat e tij për shpenzimet.
37. Mbrojtja e veçantë e nëndorësit, vetëmbrojtja dhe pacia për mbrojtjen e nëndorësit (pacia posedimore).
38. Servitutet. Llojet e tyre.
39. Uzufukti, veçoritë e tij. Dallimi nga qiraja, enfiteoza dhe renta vjetore.
40. Kuptimi i trashëgimit.
41. Pasuria që kalon në trashëgim.
42. Zotësia për të trashëguar.
43. Çelja e trashëgimisë, kuptimi, koha dhe vendi i çeljes. Rëndësia e tyre.
44. Heqja dorë nga trashëgimia, afatet dhe mënyra e heqjes dorë.
45. Trashëgimia me ligj.
46. Rrethi i trashëgimtarëve ligjorë.
47. Mënyra e thirrjes së trashëgimtarëve ligjorë.
48. Trashëgimia me përfaqësim.
49. Trashëgimia me testament. Kuptimi, rëndësia, forma e testamentit.
50. Zotësia për të bërë testament.
51. Rrethi i trashëgimtarëve me testament.
52. Caktimi dhe përjashtimi i trashëgimtarëve me testament.
53. Personat që gëzojnë rezervën ligjore.
54. Revokimi dhe pavlefshmëria e testamentit.
55. Kuptimi i mbrojtjes së trashëgimit.
56. Masat që merren për sigurimin e trashëgimit. (Inventarizimi, ruajtësi, kujdestari).
57. Legu dhe barra.
58. Dëshmia e trashëgimisë. Kuptimi, rëndësia dhe kush e lëshon.
59. Pacia për kërkimin e trashëgimit.
60. Kuptimi i kontratës, elementet, kushtet e saj dhe kushtet e vlefshmërisë.
61. Interpretimi i kontratës.
62. Faji në të drejtën civile. Përgjegjësia pa faj dhe rastet e kësaj përgjegjësie. Pakujdesia e lehtë dhe pakujdesia e rëndë.
63. Vonesa e debitorit dhe e kreditorit. Pasojat e saj.
64. Kontrata në dobi të personit të tretë. Ndryshimi i saj nga testamenti.
65. Dëmi dhe kushtet për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit.
66. Shpërblimi i plotë i dëmit, kuptimi dhe kufijtë e tij.
67. Përgjegjësia e kushtëzuar dhe rastet e saj.
68. Përmbushja në natyrë e detyrimit. Mospërmbushja dhe pasojat që vijnë prej saj.
69. Detyrimet në të holla dhe mënyra e përmbushjes së tyre.
70. Detyrimet solidare, detyrimet e pjesëtueshme dhe ato të papjesëtueshme, statusi juridik i tyre.

71. Lidhja e kontratës dhe fazat kryesore të saj. Teoritë lidhur me çastin e lidhjes së kontratës.
72. Faza parakontraktore, oferta, pranimi, kushtet e vlefshmërisë së tyre. Reklama, njoftimet, traktativat tregtare, premtimi i njëanshëm dhe kontrata paraprake, fuqia juridike e tyre.
73. Begatimi pa shkak, kushte dhe pasojat e tij.
74. Mjetet e sigurimit të përmbushjes së detyrimit, pengu, kapari, hipoteka, kushti penal, privilegjet etj. Veçoritë dhe dallimet e tyre.
75. Mënyrat e mbarimit të detyrimit.
76. E drejta e autorit.
77. Pronësia industriale.
78. Kontrata e shitjes, çasti i kalimit të pronësisë, i dorëzimit të sendit, detyrimet e shitësit. Shitja me rezervë pronësie, veçoritë e saj.
79. Kontrata e dhurimit. Ndryshimi nga testamenti dhe nga kontrata në dobi të personit të tretë. Sponsorizimi, kuptimi dhe dallimi i tij nga dhurimi. Revokimi i dhurimit, dhurimi i bërë për shpërblim.
80. Kontrata e qirasë së pasurisë, elementet, kushtet, afatet, detyrimet e palëve. Qiraja financiare. Ndryshimi i qirasë nga uzufukti dhe nga enfiteoza.
81. Kontrata e enfiteozës.
82. Kontrata e porosisë dhe veçoritë e saj. Ndryshimi nga përfaqësimi, nga komisioni dhe nga ndërmjetësimi.
83. Kontrata e agjencisë.
84. Kontrata e transportit.
85. Kontrata e sigurimit të pasurisë, kuptimi, detyrimet e palëve, çasti i hyrjes në fuqi.
86. Kontrata e sigurimit të jetës, kuptimi, detyrimet e palëve, çasti i hyrjes në fuqi.
87. Kontrata e sipërmarrjes, veçoritë e saj. Kuptimi i rrezikut.
88. Renta vjetore, kuptimi dhe karakteristikat e saj.

Legjislacioni:

- Ligji nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10 129, datë 11.5.2009 “Për Gjendjen Civile” i ndryshuar.

E Drejta Tregtare

1. Natyra juridike e së drejtës tregtare (*lex mercatoria*).
2. Funkzioni i së drejtës tregtare dhe raporti saj me shoqëritë tregtare.
3. Shoqatat dhe fondacionet. Subjektet tregtare: shoqëritë tregtare dhe tregtari person fizik.
4. Organizimi i katër formave të shoqërive tregtare. Ndarja e pushteteve dhe kompetencat respektive në një shoqëri tregtare.
5. Pjesët e kapitalit të shoqërive tregtare dhe natyra e tyre. Të drejtat e ortakëve dhe aksionerëve.
6. Pavlefshmëria e themelimit të shoqërisë tregtare dhe pavlefshmëria e akteve të saj.
7. Degët dhe grupimet e shoqërive tregtare.
8. Mbarimi i shoqërive tregtare. Likuidimi dhe falimentimi i tyre.
9. Autonomia statutore e shoqërive të kapitalit dhe ndikimi i saj në administrimin e shoqërive tregtare.
10. Funkzioni i brendshëm dhe ai i jashtëm i shoqërive tregtare.
11. Natyra juridike e kundërshtimit në rrugë gjyqësore të akteve të organeve të shoqërive tregtare.
12. Regjistrimi në regjistrin tregtar dhe kompetencat e Qendrës Kombëtare të Biznesit në raport me regjistrimet në regjistrin tregtar.
13. Marrëdhëniet e palëve në një kontratë *factoring* si dhe kalimin e kredive të llogarisë klient. Palët e kontratës *factoring* dhe marrëdhëniet juridike, që lindin ndërmjet tyre.

14. Llojet e titujve, mënyra dhe kushtet për emetimin e titujve, tregtimi dhe regjistrimi, identifikimi dhe kryerja e transaksioneve me to, individët e autorizuar për kryerjen e transaksioneve me titujt, kushtet për organizimin e tregtimit publik të titujve, mbrojtja e investitorëve dhe të mbajtësve të të drejtave mbi titujt, kushtet për dematerializimin e titujve, organizimi e funksionimi i regjistrave të titujve, shkëmbimi dhe rregullimi i tregut të titujve.
15. Falimenti dhe rregullat për shlyerjen e detyrimeve të debitorëve në një procedurë falimentimi. Agjencia e Falimentit. Kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentimit. Caktimi i administratorëve të përkohshëm të falimentimit.
16. Rregullat për përgjegjësinë, procedimin penal dhe llojet e masave ndëshkuese, që merren ndaj personave juridikë, për kryerjen e veprës penale.
17. Ndërmarrje Shtetërore dhe transformimi në Shoqëri tregtare. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
18. Rregullat dhe afatet mbi mënyrën e llogaritjes së kamatave ligjore për pagesat e vonuara, në rastet e furnizimit me mallra apo shërbime nga ana e ndërmarrjeve tregtare kundrejt ndërmarrjeve të tjera tregtare dhe autoriteteve publike.

Legjislacioni:

- Ligji nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr.9901 datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.
- Ligji nr.110 datë 15.11.2012 “Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9723 datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar.
- Ligji nr. 9630, datë 30.10.2006 “Për faktoringun”, i ndryshuar.
- Ligji nr.9879 datë 21.2.2008 “Për titujt”.
- Ligji nr. 110/2016 “Për falimentimin”.
- Ligji nr. 9754 datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”.
- Ligji nr.7582 datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, i ndryshuar.
- Ligji nr.7926 datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare” i ndryshuar.
- Ligji nr.8957 datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.

Procedurë Civile

1. Gjykata si subjekt i procesit civil.
2. Gjykimi për vërtetimin gjyqësor të fakteve.
3. Përmbajtja e ankimit dhe rekursit, dallimi ndërmjet tyre.
4. Barra e provës.
5. Kundërankimi (apeli kundërshtues dhe kundër rekursi).
6. Gjykimi për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar.
7. Padia, llojet e padive, elementet e saj.
8. Gjykimi për deklarimin e një personi si të zhdukur ose të vdekur.
9. Llojet e padive, shkaqet që justifikojnë ngritjen e padisë.
10. Gjykimi për zhvlerësimin e letrave me vlerë.
11. Kushtet për të ushtruar të drejtën e padisë.
12. Kundërshtimi i veprimit ose i refuzimit të përmbartuesit gjyqësor për të kryer një veprim të caktuar.
13. Përmbajtja e kërkesë padisë. Elementet e saj.
14. Ekzekutimi i detyrimeve për kryerjen e një veprimi të caktuar.
15. Kundërpadia. Dallimi i saj nga prapësimi dhe nga padia.
16. Pjesëtimi gjyqësor.

17. Kuptimi i provave.
18. Legjitimiteti aktiv dhe legjitimiteti pasiv i palëve.
19. Llojet e provave.
20. Kundërshtimi i vlefshmërisë së titullit ekzekutiv.
21. Thëniet e dëshmitarëve.
22. Kundërshtimi i veprimeve përbarimore nga personi i tretë.
23. Provat shkresore.
24. Procedura e gjykimit të kundërshtimeve të veprimeve të përbaruesit gjyqësor.
25. Provat materiale.
26. Titujt ekzekutivë dhe urdhri i ekzekutimit.
27. Mendimi i ekspertit.
28. Padiësi si subjekt i procesit gjyqësor civil
29. Çmuarja e provave.
30. I padituri si subjekt i procesit gjyqësor civil.
31. Klasifikimi i provave.
32. Ndërhyrësit kryesorë si subjekte të procesit gjyqësor civil.
33. Kufizimi i përdorimit të thënieve të dëshmitarëve.
34. Marrëdhëniet juridike procedurale ekzekutive, elementet dhe përmbajtja.
35. Procedura e pyetjes së dëshmitarëve.
36. Ekzekutimi i detyrimeve për dorëzimin e sendeve.
37. Shkresa e thjeshtë.
38. Ndërhyrësit dytësor si subjekte të procesit gjyqësor civil.
39. Kundërshtimi i vërtetësisë së dokumenteve.
40. Objekti i të provuarit në gjykim.
41. Veprimet e përbaruesit gjyqësor për ekzekutimin vullnetar.
42. Rishikimi i vendimit.
43. Veprimet e përbaruesit gjyqësor për ekzekutimin forcërisht të detyrimit.
44. Kuptimi material i padisë dhe kuptimi procedural i saj. Pasojat që sjell padia pas regjistrimit të saj në gjyq.
45. Veprimet e përbaruesit gjyqësor për ekzekutimin e detyrimeve në të holla kundrejt shtetësive.
46. Sigurimi i padisë dhe sigurimi i provës, dallimi ndërmjet tyre.
47. Njohja e vendimeve të shteteve të huaja.
48. Gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit.
49. Marrëdhëniet me element të huaj.

Legjislacioni:

- Ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 8867, datë 14.3.2002 Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Statutin e Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private”.
- Ligji Nr. 10182, datë 29.10.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Konferencës së Hagës “Për procedurën civile”.
- Ligji nr. 9554, datë 8.6.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtë gjyqësore në fushën civile dhe tregtare”.
- Ligji nr.11/2017“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
- Ligji nr.10194, datë 10.12.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja në fushën civile dhe tregtare”.
- Ligji nr.8688, datë 09.11.2000, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit”.

- Ligji nr. 8687, datë 09.11.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Evropiane të Arbitrazhit”.
- Ligji nr.9060, datë 08.05.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja”.
- Ligji nr. 10428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”

E Drejta Penale

1. Ligji penal dhe ndarja e veprave penale
2. Bazat e legjislacionit penal
3. Detyrat e legjislacionit penal
4. Parimet e Kodit Penal
5. Mosdënimi pa ligj
6. Veprimi në kohë i ligjit penal
7. Mosnjohja e ligjit
8. Territori i Republikës së Shqipërisë
9. Zbatimi i ligjit penal për vepra penale të kryera nga shtetas shqiptarë
10. Zbatimi i ligjit penal për vepra penale të kryera nga shtetas të huaj
11. Juridiksioni universal
12. Zbatimi i ligjit penal për vepra penale të kryera nga personi pa shtetësi
13. Personat e mbrojtur ndërkombëtarisht
14. Përgjegjësia për personat e huaj që gëzojnë imunitet
15. Fuqia e vendimeve penale të gjykatave të huaja
16. Ekstradimi
17. Mosha për përgjegjësi penale
18. Lidhja shkakësore
19. Faji
20. Dashja
21. Pakujdesia
22. Papërgjegjshmëria për shkak të gjendjes mendore
23. Kryerja e veprës penale në gjendje të dehur.
24. Mbrojtja e nevojshme.
25. Nevoja ekstreme.
26. Ushtrimi i një të drejte apo përmbushja e detyrës
27. Heqja dorë nga kryerja e veprës penale
28. Dënimet kryesore
29. Dënime plotësuese
30. Dënimi me burgim të përjetshëm
31. Dënimi me burgim
32. Dënimi me gjobë
33. Zbatimi i ligjit penal ndaj personave juridikë
34. Masat mjekësore dhe edukuese
35. Caktimi i dënimit
36. Alternativat e dënimit me burgim
37. Shuarja e ndjekjes penale, të dënimeve dhe mosekzekutimi i tyre.
38. Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike
39. Vjedhja e pasurisë
40. Mashtrimet
41. Shkatërrimi i pronës
42. Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare
43. Vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare
44. Krime në fushën e doganave
45. Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet

46. Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë
47. Falsifikimi i dokumenteve
48. Vepra penale në fushën e falimentimit
49. Vepra penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve
50. Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik.

Legjislacioni:

- Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr. 9754 datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”.
- Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Procedura Penale

1. Parimet kryesore të procedimit penal; parimi i ligjshmërisë; parimi i pavarësisë së gjykatës; parimi i prezumimit të pafajësisë; parimi i sigurisë së lirisë; prova dhe parimi i lirisë së provës; parimi i sigurimit të mbrojtjes; parimi i ndalimit të gjykimit dy herë për të njëjtën vepër; parimi i rivendosjes së të drejtave; parimi i zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare.
2. Subjektet e procedimit penal; Gjykata; Prokuroria; Policia Gjyqësore; I Pandehuri; Mbrojtësi; Viktima; Padiësi civil; I padituri civil.
3. Hetimet paraprake. Marrja dijeni për veprën penale. Kushtet e procedimit. Veprimtaria e subjekteve të procedimit penal gjatë fazës së hetimeve paraprake. Veprimet paraprake për gjykimin e çështjes.
4. Dallimi mes gjyqtarit të hetimeve paraprake, gjyqtarit të seancës paraprake dhe gjyqtarit të gjykimit të çështjes në themel.
5. Afatet e përfundimit të hetimeve, zgjatja e afateve dhe ankimi ndaj tyre.
6. Përfundimi i hetimeve, pushimi i akuzës ose çështjes, roli i prokurorit dhe i gjyqtarit të seancës paraprake.
7. Provat. Kuptimi i provës. Objekti i të provuarit. Procesi i të provuarit dhe fazat e tij. Llojet e provave.
8. Mjetet e kërkimit të provës. Provat indirekte. Sigurimi i provës dhe çmuarja e provave.
9. Policia gjyqësore dhe funksionet e saj.
10. Viktima akuzuese në procesin penal.
11. Viktima në procesin penal dhe të drejtat e saj në fazën e hetimit paraprak.
12. Padi civile në procesin penal.
13. Juridiksioni. Kuptimi i juridiksionit penal dhe raportet e tij me juridiksionet e tjera. Kompetenca. Llojet e kompetencave. Mosmarrëveshjet për kompetencën.
14. Bashkimi dhe ndarja e çështjeve.
15. Aktet kryesore të procedimit penal. Pavlefshmëria e akteve.
16. Njoftimet, afatet për kryerjen e veprimeve të procedimit penal.
17. Gjykimi në shkallë të parë. Veprimet përgatitore, shqyrtimi gjyqësor. Vendimi i gjykatës.
18. Gjykimeve të posaçme. Gjykimi i drejtpërdrejtë. Gjykimi i shkurtuar. Gjykimi me marrëveshje dhe gjykimi me urdhër penal, si lloje të gjykimeve të posaçme.
19. Mjetet e ankimit, llojet dhe dallimet midis tyre.
20. Gjykimi në Gjykatën e Apelit. Objekti dhe subjektet e gjykimit në apel. Mënyrat e disponimit të Gjykatës së Apelit.
